



Nr. Prot

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Njoftimi i shkurtuar i Kontratës

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.
Tel/Faks +355 42 228 349, +355 42 239 295
E-mail info@kesh.al
Ueb-faqe www.kesh.al

2. **Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, mallra.

3. **Numri i referencës së procedurës /Lotit:** Nr. Ref- 16367-08-15-2024

4. **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** Furnizim vendosje i kushinetave rrëshqitëse në aksin e rrotullimit të farfallës së droselit për 4 AG në HEC Koman dhe një set rezervë.

5. **Fondi limit:** 95,000,000 (Nëntëdhjetë e pesëmilion) Lek, pa TVSH ose 951,999 (Nëntëqind e pesëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 15/08/2024 është 99.79Lekë/Euro

6. **Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 18 (tetëmbëdhjetë) muaj.

7. **Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** Data 09/09/2024 Ora:10.00.

Shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42 pika 6 të LPP:

Prokurimi i objektit “Furnizim vendosje i kushinetave rrëshqitëse në aksin e rrotullimit të farfallës së droselit për 4 AG në HEC Koman, dhe nje set rezerve” është nevojë emergjente të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur, pasi AG2 në HEC Koman është jashtë gadishmërie, për shkak të problematikës së shfaqur tek kushinetat e droselit. Kushinetat e droselit jane paisje mekanike specifike që prodhohen me porosi në fabrikë. Nga eksperianca e rehabilitimit ne 2015, koha e prodhimit shkon te paktën 12 jave dhe koha e montimit 30 dite. Gjatë kohës së montimit, duhet të dalin jashtë gadishmerie dy agregate, për shkak të filozofisë së projektuar së HEC Koman me tubacion Y. Kjo mund të sjellë që në periudhën e lagësht të vitit mund të gjendemi me dy agregate jashtë gadishmërie, që do të sjellë shumë humbje për shkak të mos



prodhimit. Sa më sipër është e nevojshme që të caktohen afatet minimale që lejon ligji për të përshpejtuar kohën e fillimit të kontratës, në mënyrë që ndërrimi i kushinetës tek AG2 të arrihet të realizohet përpara periudhës së lagësht të vitit. Argumentuar sa më sipër, AK vendos shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave nga 35 ditë në 24 ditë.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erald Elezi